


PLANI I SHËRBIMEVE SOCIALE

BASHKIA KRUJE



2017-2020

1. HYRJE

Plani i Shërbimeve Sociale të Bashkisë Krujë i prezantuar në vazhdim është një dokument i bazuar në një qasje gjithpërfshirëse i cili synon të adresojë nevojat për shërbime sociale, fuqizimin e strukturave përgjegjëse vendore, si dhe përmirësimin e shpërndarjes dhe llojshmërisë së shërbimeve.

Plani është hartuar përmes një procesi konsultimi me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse vendore, shoqërisë civile si dhe grupeve në nevojë për të garantuar një vlerësim sa më afër nevojave reale të grupeve dhe komuniteteve të ndryshme dhe mundësive për të adresuar këto nevoja nga aktorë të ndryshëm.

Reforma e re administrative-territoriale ka sjellë një sërë ndryshimesh në kompetencat e njësive të qeverisjes vendore si në shtrirje ashtu edhe në krijimin dhe administrimin e shërbimeve në nivel lokal.

Në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në nenin 24 përcaktohet se “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, të cilat fokusohen veçanërisht në krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, etj.¹ Këto funksione dhe përgjegjësi të reja nxjerrin në pah edhe nevojën e një procesi gjithpërfshirës të programimit, planifikimit dhe monitorimit të shërbimeve sociale në nivel vendor, duke shtuar këtu edhe zgjerimin e territorit dhe popullatës që Bashkia duhet të mbulojë me shërbime.

Njësitë e qeverisjes vendore kanë përgjegjësinë për të planifikuar dhe buxhetuar shërbimet e përkujdesit social bazuar në vlerësimin e nevojave, identifikimin e burimeve financiare dhe partneriteteve vendore.

Planifikimi është një komponent shumë i rëndësishëm i zbatimit në praktikë të programeve dhe strategjive, i cili konsiderohet gjithashtu esencial në gjithë veprimtarinë e organizatave, institucioneve, agjensive sociale dhe shpërndarjen e shërbimeve të ndryshme në nivel vendor.

Strategjia e Mbrojtjes Sociale (2015 – 2020) adreson çështjet e varfërisë dhe mbrojtjes sociale të grupeve në rrezik përjashtimi nëpërmjet (i) skemës së ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, (ii) shërbimeve të kujdesit shoqëror ekzistuese dhe ato të propozuara dhe

¹ Ligj nr. 115/2014 datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

(iii) çdo çështje tjetër në fushën e mbrojtjes sociale. Ajo përbën bazën për komponentin e Mbrojtjes Sociale të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI 2015-2020). Synimet strategjike të Mbrojtjes Sociale janë gjithashtu të ndërthurura më gjerë në përbërës të tjerë të SKZHI-së.

Strategjia synon reformimin e Programit të Mbrojtjes Sociale nëpërmjet transformimit të Ndhmës Ekonomike në një skemë aktive të riintegritit social; rishikimin e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar ; ndërhyrjes dhe riintegritit të fëmijëve në familje e komunitet duke treguar kujdes të veçantë për fëmijët jetimë social dhe biologjikë dhe ofrimin e shërbimeve të integruara. Prioritet i saj është sigurimi i burimeve të nevojshme për grupet më të rrezikuara nëpërmjet Fondit Kombëtar për Shërbimet Shoqërore dhe Fondeve Rajonale për Shërbimet Shoqërore si pjesë e Fondit Shoqëror.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet që strategjia përcakton përgjegjësi dhe role të qarta për njësitë e reja administrative për planifikimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në territoret e tyre në përputhje edhe me ligjin për vetëqeverisjen vendore² dhe strategjinë e decentralizimit. Gjithashtu projekt ligji për Shërbimet e përkujdesit social do të mundësojë bazën ligjore që sistemi të bëhet funksional si dhe modelin e ofrimit të paketës standarte të shërbimeve në nivel vendor.

Plani i shërbimeve sociale është bazuar në qasjen e ofrimit të një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë si dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato lokale, si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e shërbimeve sociale.

Ai shoqërohet gjithashtu me Planin e Veprimit (2017-2020) i cili është i ndarë në pesë fusha kryesore : (1) Strukturat dhe burimet njerzore ; (2) Shërbimet Sociale në Bashkinë e Kruje ; (3) Zbutja e varfërisë; (4) Programet parandaluese; (5) Koordinimi dhe rrjetëzimi i shërbimeve dhe përcakton qëllimet dhe objektivat specifike, aktivitetet e parashikuara në terma kohorë, përgjegjësitë institucionale dhe burimet për realizimin e tyre.

² Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

2. PARIMET E PLANIT SOCIAL

Plani Social i Bashkisë Kruje (2017-2020) është në linjën e parimeve të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale (2015-2020) të cilat rrjedhin nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut , Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, Konventa për të Drejtën e Personave me Aftësi të Kufizuara, Karta Sociale Evropiane e rishikuar, Karta Evropiane e Autonomisë Lokale, Komunikata e Komisionit Evropian datë 12 Mars 1997 “Mbi modernizimin dhe përmirësimin e Mbrojtjes Shoqërore”, Strategjinë Evropiane deri në 2020.

E drejta për mbrojtjen sociale është reflektuar në Kushtetutën e Shqipërisë³. neni 9 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore njeh të drejtën e secilit individ për të pasur mbrojtje sociale. Në mënyrë të ngjashme, në Konventat e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara njohin gjithashtu të drejtat e veçanta për mbrojtjen sociale⁴. Parimet janë|:

Të drejtat civile, barazia dhe mosdiskriminimi: Mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, feja, mosha, aftësitë e kufizuara, etj.

Mbrojtja: Grupe të veçanta, duke përfshirë fëmijët, duhen të jenë subjekt i mbrojtjes së veçantë bazuar në nevojat dhe të drejtat e tyre.

E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit: Një mjedis i përshtatshëm duhet të mbështesë zhvillimin maksimal të individëve.

Pavarësia, autonomia dhe respektimi i pikëpamjeve: Individët janë përgjegjës për jetën e tyre. Ata duhet të inkurajohen që të marrin vendime për jetën e tyre brenda normave që shoqëria ka vendosur.

Përfshirja dhe integrimi.

Respektimi i të drejtave dhe nevojave.

Partneriteti: Koordinimi i strukturave qendrore, qeverisjes rajonale dhe vendore, si dhe partnerë të tjerë në komunitet.

Cilësia e shërbimeve.

Standardet Kombëtare udhëheqin vendimmarrjen në nivel vendor.

³Neni 52.2. thekson se “Çdo person që për arsye të mos dëshirës së tij/saj humbet punën dhe nuk ka mjete të tjera mbështetjeje, ka të drejtën për ndihmë sociale, sipas kushteve që parashikon ligji”

⁴Nenet 26 dhe 28 respektivisht.

Referuar sërish Strategjisë së Mbrojtjes Sociale plani social është i bazuar në politikat e mëposhtme:

A. Zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë, duke mundësuar mbulimin më të mirë të familjeve dhe individëve të varfër dhe ekstremisht të varfër, përmirësimin e shenjestrimit të tyre, rritjen e transparencës dhe shmangien e abuzivitetit në skemën e Ndhmës Ekonomike, si dhe lidhjen me shërbime të integruara dhe skemat e punësimit, me qëllim riintegrimin social të tyre.

B. Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara, nëpërmjet vlerësimit bio-psiko-social bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke ndërthurur skemën e pagesave në Cash me shërbime të integruara, me qëllim integrimin në jetën shoqërore dhe ekonomike.

C. Zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social, bazuar në parimet e decentralizimit dhe deinstitucionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e Mbrojtjes Sociale, si dhe inkurajon pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në shoqëri.

3. TË DHËNA EKONOMIKE DHE DEMOGRAFIKE

-Popullata, struktura gjinore

Bashkia Kruje kufizohet në perëndim me rrethin e Durrësit , në veri me rrethin e Lacit, në lindje me rrethin e Matit dhe në jug me rrethin e Tiranës . Popullsia e Krujes është 80807 banorë.

Kjo bashki përbëhet nga gjashtë njësi administrative, të cilat janë: Kruje, Fushe-Kruje, Thumane, Nikel, Bubq dhe Cudhi .

Të gjitha njësitë e Bashkisë së re bëjnë pjesë në rrethin Kruje, qarku Durrës. Në territorin e saj gjenden dy qytete Kruje dhe Fushe-Kruje si dhe 44 fshatra.

Në bazë të dhenave popullsia e rrethit Kruje është e shpërndarë si më poshtë :

PLANI I SHËRBIMEVE SOCIALE

<i>Bashkia Kruje dhe</i>	<i>Nr. Banore</i>	<i>Nr. Familje</i>
<i>Njesite administrative</i>	80807	22621
Kruje	16342	5001
Fushe-Kruje	26277	7223
Thumane	16253	4386
Nikel	10219	2653
Bubq	8617	2385
Cudhi	3099	973

Tabela 1.1 Te dhena te marra nga Gjendja Civile Kruje

Struktura e popullsisë në Bashkinë e Krujes sipas gjinisë dhe grupmoshës për secilën nga Njësitë Administrative të saj paraqitet si më poshtë (Census 2011) :

Bashkia/ NJA	Gjinia dhe grupmosha												
	Gjithsej					Meshkuj				Femra			
	Gjiths ej	0-14	15-64	65+	Gjiths ej	0-14	15-64	65+	Gjit hsej	0-14	15- 64	65+	
Gjithsej													
Kruje	11721	2334	8057	1330	6027	1252	4114	661	5694	1082	3943	669	
Fushe - Kruje	18477	4504	1248 3	1490	9571	2391	6505	675	8906	2113	5978	815	
Thuman e	12335	2955	8184	1196	6282	1596	4127	559	6053	1359	4057	637	
Nikel	9518	2570	6190	758	4882	1351	3157	374	4636	1219	3033	384	
Bubq	5951	1250	4008	693	3010	658	2033	319	2941	592	1975	374	
Cudhi	1812	480	1162	170	971	257	631	83	841	223	531	87	

Tabela 1.2 Popullsia banuese sipas gjinisë, grupmoshës bashkisë/komunës (INSTAT, Census 2011)

- **Niveli i papunësisë**

Sipas Zyrës Rajonale të Punës të Krujes, forcat aktive për të punuar llogariten rreth 21286 njerëz. Niveli i të papunëve ne Kruje ka qene rreth 12.8 % ne vitin 2014, 14.7% ne vitin 2015 dhe 6.9 % ne vitin 2016 , ku papunësia është më e përhapur te meshkujt.

	2014	2015	2016
Femra	1324	1528	742
Meshkuj	1395	1703	766
Totali	2719	3231	1508

Tabela 1.3 Niveli i Punësimit (Zyra Rajonale e Punës, Kruje, 2017)

4. ANALIZA E SITUATËS

- **Mbrojtja sociale**

Sipas të dhënave në Drejtorinë e Shërbimit Social, ne Bashkine Kruje situata e përfituesve të ndihmës ekonomike për 3 vitet e fundit paraqitet si më poshtë:

2014	2015	2016
Perfitues	Perfitues	Perfitues
418	426	563

Tabela 1.4. Familjet përfituese të ndihmës ekonomike

- **Personat me aftësi të kufizuar**

Lidhur me programin e pagesave kesh të invaliditetit për Bashkinë Kruje ne vitin 2014 paraqiten 1769 persona me PAK, ne vitin 2015 ka nje renie dhe numri shkon 1669 Pak dhe ne vitin 2016 ka nje rritje te vogel numri i PAK eshte 1686.

Viti	2014	2015	2016
Nr. i përfituesve	1769	1669	1686

Tabela 1.5 Numri i përfituesve të pagesave PAK

- Numri i viktimave të dhunës në familje

Të dhënat e DSHS të Bashkisë tregojnë se numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara nga mekanizimi i referimit të rasteve të dhunës në familje (gjykata, policia, prokuroria, etj.), për 6 mujorin e parë të 2017 janë paraqitur 7 raste . Gjithashtu vihet re që ka një rritje të numrit të tyre , nderkohe qe per vitet e meparshme mungojnë të dhënat.

Shërbimet mbizotëruese duken se janë këshillimi psikologjik, mbështetja ligjore dhe pajisja me Urdhër Mbrojtje të cilat në pjesën më të madhe ofrohen nga OJF-të.

Sipas të dhënave numri i popullsisë Rome në Rrethin e Krujes është 796 ndërsa popullsia Egjyptian është 841 . Pjesa më e madhe e kesaj popullsie jeton ne Njesine Administrative Fushe-Kruje.

- Shërbimet e përkujdesit shoqëror

Shërbimet e përkujdesit shoqëror të Bashkisë së Krujes janë të përqëndruara kryesisht për kategoritë më në nevojë, si shërbime rezidenciale dhe ditore për fëmijët, të moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara. Këto shërbime ofrohen si nga Bashkia ashtu edhe nga OJF-të:

Rezidencial publik	Jo-publik	Qender ditore
1		2

Tabela 1.7 Shërbimet e përkujdesit (SHS Bashkia Kruje)

Per femijet eshte qe qendra rezidenciale Betania e cila eshte krijuar ne Njesine administrative Bubq ne vitin 1998 . Ajo ofron ndihma te konsiderueshme ne ushqime dhe veshmbathje. Aktualisht strehon 56 femije dhe tre familje ne nevoje.

Per personat me aftesi te kufizuar kemi qendren ditore “ Jete ne Zhvillim” ne Arrameras ne Fushe-Kruje e cila eshte nje qender multifunksionale e cila ofron sherbime sociale per 32 Persona me Aftesi te kufizuar . Veprimtaria e kesaj qendre eshte e orientuar per klientet drejt zhvillimit te aftesive , njohurive dhe vetekuptimit te tyre.

Per te moshuarit gjithashtu kemi qendren ditore ne Fushe-Kruje e cila sherben si nje ambient argetimi per te moshuarit, ato kalojne ditën me lojra si dhe u ofrohet kafe , caj etj. Frekuentohet pergjithsisht nga 90-100 te moshuar.

- **Mangësitë dhe mundësitë për zhvillimin e shërbimeve sociale në Bashkinë Kruje**

Aktualisht kategoritë në nevojë për të cilat ofrohen shërbime në territorin e Krujes janë disa, fëmijët, të moshurit, PAK. Konkretisht nje qender ditore per te moshuar, nje qender ditore per PAK dhe nje qender rezidenciale per femijet. Tipologjia e shërbimeve konsiston në dy lloje, shërbime rezidenciale (1) dhe shërbime ditore (2) për kategoritë e mësipërme të grupeve në nevojë, të cilat ofrojnë kryesisht mbështetje materiale dhe ushqimore, fuqizim, mbështetje psiko-sociale dhe shkollore.

Aktualisht Bashkia Kruje financon dhe menaxhon 1 shërbim, Qendren ditore per të moshuar ne Fushe-Kruje e cila frekuentohet nga 90 deri ne 100 te moshuar cdo dite. Të gjitha shërbimet e tjera ofrohen nga organizata ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale. Vlen të theksohet se të gjitha shërbimet e lartpërmendura janë të përqëndruara ne Njesine administrative Fushe-kruje dhe Bubq.

Duke analizuar situatën e shërbimeve aktuale rezulton se një pjesë e konsiderueshme e grupeve në nevojë mbeten në nivele të pamjaftueshme apo plotësisht të pa mbuluara me shërbime në territorin aktual të mbuluar nga Bashkia e Krujes, të tilla si: shërbimet për fëmijët e rrugës, shërbimi i kujdestarisë, shërbimet emergjencës (48H) për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit, shërbimet për të rinjtë, shërbimet alternative për prindër dhe familje, shërbimet për persona që abuzojnë me substance.

Nderkohe ne bashkepunim me Fondacionin “ Ndihme per femijet” po punohet per hapjen e nje qendre ne sherbim te femijeve rom ne zonen e Fushe-Krujes duke qene se edhe vete komuniteti rom dhe egjiptian eshte i perqendruar ne ate zone.

Ndërkohë që vetë ofruesit e shërbimeve janë të opinionit se mbetet e mjaft rëndësishme të vazhdojë mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve egzistuese për fëmijët me AK , shërbimet komunitare për moshën e tretë, shërbimet mbështetëse për të mbijetuarit e dhunës në familje.

- **Analiza e palëve të interesuara**

Aktorët kryesorë të përfshirë në procesin e hartimit dhe të cilët do të kontribuojnë në zbatimin e PSHS të Bashkisë Kruje janë: Bashkia Kruje me strukturat e saj vendimmarrëse (Këshilli Bashkiak dhe drejtuesit e institucionit), Drejtoria e Shërbimeve Sociale , Drejtoria Rajonale Shërbimit Social, Zyra Rajonale e Punësimit, Drejtoria Rajonale Arsimore, Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik, Institucionet e Përkujdesit Social, Organizatat kombëtare dhe lokale të Shoqërisë Civile që ofrojnë shërbime, Organizatat ndërkombëtare që mbështesin programet e ndryshme, Biznesi, etj.

Nga analiza e vlerësimit të situatës rezulton se si rrjedhë e ndryshimeve që solli reforma administrative territoriale, një nga problemet më shqetësuese për strukturat kryesore përgjegjëse për shërbimet sociale, DSHS në Bashki, ka mbetur e pa ndryshuar si në numër stafi edhe në strukturën e saj, pavarësisht se territori që kjo drejtori mbulon është zmadhuar ndjeshëm. Kjo ka sjellë një mbingarkesë të punës për stafin, dhe si rrjedhë pamundësi për të adresuar nevojat e grupeve dhe komuniteteve egzistuese dhe të reja, si dhe mungesa në shpërndarjen e shërbimeve në të gjithë territorin .

Gjithsesi në këtë Bashki vihet re një tendencë për të iniciuar partneritete të cilat do të mundësonin ofrimin e shërbimeve për kategoritë e ndryshme. Mungesa e burimeve financiare të mjaftueshme për shërbime të shpërndara dhe të shumëllojshme të përkujdesit mbetet një problematikë serioze në situatën e shërbimeve sociale në Kruje.

- **Konkluzione**

Strukturat e shërbimeve sociale

- Struktura e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në Bashkinë e Krujes është e pamjaftueshme në burime njerëzore në situatën e re të ndarjes administrative pasi personeli përgjithësisht është i mbingarkuar me përgjegjësi dhe role të mbivendosura.
- Në stafin e NJA-ve gjejmë problematika të lidhura me formimin e papërshtatshëm për

pozicionin dhe rolet, mungesa të kualifikimeve të përshtatshme profesionale për një pjesë të personelit apo mungesa të eksperiencave në praktikën e shërbimeve sociale. Mungon përdorimi i një qasje multisektoriale në menaxhimin e rasteve si dhe raportohen mangësi në zbatimin e mekanizmit të referimit për viktimat e DHF .

- Megjithë vështirësitë , vihet re se i gjithë stafi i DSHS tregon angazhim, sens motivimi dhe përpjekje mjaft serioze, për të realizuar përgjegjësitë e tyre, shpeshherë edhe përtej mundësive që i'u lejojnë kushtet institucionale, sidomos në drejtim të menaxhimit të rasteve të vështira si dhe ruajtjen e marredhënieve me institucionet rajonale dhe qëndrore apo OJF-të që operojnë në territor.

Situata e grupeve në nevojë

- Bazuar në analizën e të dhënave rezulton se problemi i varfërisë në qytetin e Krujes është i adresuar në mënyrë të kënaqshme, duke përdorur në mënyrë të balancuar mbulimin me pagesa nga sistemi i NE ashtu si edhe fondet e Bashkisë.
- Megjithëse ndër vite numri i personave me AK është rritur ndjeshëm, si fëmijë dhe të rritur, vihen re mungesa të theksura në shërbime alternative të shpërndara në territor, sidomos shërbimet në shtëpi apo qendrat ditore, të cilat në zonat e NJA-ve mungojnë totalisht.
- Lidhur me kategorinë e të moshuarve, në Kruje vihet re mungesa e një qendre rezidenciale për një numër të moshuarish të vetmuar dhe pa mbështetje të cilët jetojnë në kushtet të vështira social-ekonomike dhe shëndetësore si dhe shërbimet në shtëpi . Po ashtu mungojnë shërbimet ditore dhe hapesirat për moshën e tretë ne vet qytetin e Krujes.
- Kategori të tjera në nevojë që përballen me probleme komplekse dhe mungesë të shërbimeve adeguate janë gratë e mbijetuara të DHF dhe trafikimit të cilat mbështeten pjesërisht me asistencë ligjore dhe psiko-sociale por jo me shërbime riintegruese.
- Fëmijët në situatë rruge dhe ata pa kujdes prindëror janë dy grupet më problematike të kësaj kategorie, të cilët edhe pse në një numër shume te vogel, janë plotësisht të pa mbrojtur dhe të pa mbuluar me shërbime.

Shërbimet e përkujdesit dhe partneriteti

- Mungesa e planeve sociale ka sjellë një shpërndarje kaotike të shërbimeve. Strukturat raportojnë mungesë të shërbimeve si në sasi, shpërndarje dhe llojshmëri, në raport me nevojat komplekse të grupeve të ndryshme. Llojet e shërbimeve të cilat ofrohen aktualisht nga institucionet publike dhe OJF-të janë fokusuar tek shërbimet për fëmijët, të moshuarit dhe personat me PAK.
- Lidhur me bashkëpunimin me OJF-të të cilat ofrojnë shërbime në territor, bashkia nuk përdor ndonjë marrëveshje partneriteti me organizatat e shoqërisë civile që ofrojnë shërbime në territorin e saj, por ofron mjedis pozitiv bashkëpunimi sidomos në drejtim të referimit të rasteve të ndryshme.
- Të gjithë aktorët e përfshirë në hartimin e Planit të shërbimeve sociale kanë identifikuar problematikën e mungesës së një sistemi të standartizuar të mbledhjes së të dhënave që për rrjedhojë ka sjellë mangësi në vlerësimin e nevojave të grupeve dhe komuniteteve të ndryshme, planifikim dhe monitorim të programeve sociale.

5. VIZIONI I PLANIT SOCIAL

Shërbimet sociale në Bashkinë e Krujes do të jenë gjithëpërfshirëse, të shpërndara në territor, të shumëllojshme dhe të bazuara në nevojat sociale gjithnjë në rritje të popullatës. Ato do të ofrohen në përputhje me standardet dhe kornizën ligjore të shërbimeve sociale, dhe bazuar në qasjen me personin në qendër, atë multisektoriale dhe të menaxhimit të rastit. Bashkia e Krujes do të ngrejë një sistem të balancuar shërbimesh sociale të cilat do të kenë në fokus grupet në nevojë, duke synuar një mbulim më të mirë të nevojave ekonomike të tyre, një mbulim më të plotë me shërbime të tjera të përkujdesit shoqëror nëpërmjet zhvillimit të mëtejshëm të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror dhe ndërtimit të shërbimeve të reja sipas modeleve të praktikave të mira bashkëkohore dhe shtrirjes së tyre në të gjitha njësitë administrative. Sistemi i shërbimeve të përkujdesit shoqëror në Kruje do të ketë në dispozicion burime njerëzore, materiale të mjaftueshme për të siguruar shërbime të standartizuara.

6. QËLLIMET, OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Plani i veprimit

FUSHA 1: KOORDINIMI DHE RRJETËZIMI I SHËRBIMEVE

Qëllimi 1 : Forcimi i strukturave koordinuese dhe monitoruese të shërbimeve sociale

Objektivi 1.1: Të fuqizohen strukturat koordinuese në Bashki dhe NJA

Aktivitetet:

1. Rritje e numrit të nje punonjesi të NjMF
2. Plotësimi i strukturës me staf mbështetës (1 jurist)
3. Organizimi i takimeve periodike për forcimin e rrjetit të shërbimeve në nivel vendor
4. Rritje e numrit të punonjësve të barazisë gjinore (1 për bashkinë dhe çdo NJA)

Aktorët përgjegjës: DSHS, MMRS, NJA, OJF

Objektive 1.2 Të krijohen formate të standartizuara për menaxhimin e rasteve, monitorimin dhe raportimin.

Aktivitetet:

1. Hartimi i nje formati standart për menaxhimin e rasteve
2. Krijimi i nje baze të dhënash për përfituesit dhe shërbimet
3. Forcimi i kapaciteteve të stafit.

Aktorët përgjegjës: DSHS, MMRS, NJA, OJF

FUSHA 2 : STRUKTURAT DHE BURIMET NJERZORE

Qëllimi 2. Fuqizimi i strukturave dhe kapaciteteve të shërbimeve sociale

Objektivi 2. 1 : Ngritja e Njësisë të vlerësimit të nevojave dhe e referimit të rasteve (NVRR) në çdo NJA.

Aktivitetet:

1. Krijimi i strukturës së NVRR për çdo njësi administrative sipas numrit të popullsisë dhe nevojave për shërbime;
2. Hartimi i planit të punës së funksionimit të NVRR

Aktorët përgjegjës: Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Burimeve Njerzore, Njësitë Administrative

Objektivi 2.2: Të fuqizohen strukturat e shërbimeve sociale në Bashkinë e Krujes dhe NJA

Aktivitetet:

1. Rritje e numrit të punonjesve të shërbimit social për Bashkinë dhe Njësitë Administrative.

Aktorët përgjegjës: DSHS, NJA

Objektivi 2.3: Të rriten kapacitetet e stafëve të strukturave të Shërbimit social në Bashki dhe Njësi Administrative.

Aktivitetet:

1. Trajnime për procedurën që do të ndiqet për funksionimin e NVRR.
2. Trajnime për rritjen profesionale, menaxhimin dhe planifikimin.

Aktorët përgjegjës: DSHS, MMRS., NJA,

Objektivi 2.4 Të përmirësohen kushtet e punës dhe logjistika e strukturave të shërbimit social në Bashki dhe NJA

Aktivitetet:

1. Sigurimi i ambjeteve dhe kushteve të përshtatshme për punë në Bashkinë Kruje dhe Njësitë administrative.
2. Sigurimi i mjeteve të punës;

Aktorët përgjegjës: DSHS, NJA

FUSHA 3: SHËRBIMET SOCIALE NË BASHKINË E KRUIJES

Qëllimi 3. Përmirësimi i shërbimeve sociale në territorin e Bashkisë së Krujes

Objektivi 3.1: Të përmirësohet situata e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve.

Aktivitetet:

1. Ngritja e nje qendre ditore ne Bashki dhe Njesi administrative
2. Hartimi i modelit te sherbimit
3. Funksionimi i qendres

Aktorët përgjegjës: DSHS, ASHDMF, DRSHSSH, NJA

Objektivi 3.2: Të ofrohen shërbime lehtësuese dhe mëshitetëse për gratë kryefamiljare.

Aktivitetet:

1. Konsulence ligjore falas per lehtesimin e procedurave per grate kryefamiljare
2. Nxitja e grave per perfshirje ne programet e punesimit dhe siper marrje private.

Aktorët përgjegjës: DSHS, OJF, Biznesi

Objektivi 3.3: Të ofrohen shërbime alternative për moshën e tretë.

Aktivitetet:

1. Ngritja e nje Qendre ditore per te moshuarit.
2. Hartimi i modelit te sherbimit te ofruar.
3. Venia ne funksionim e sherbimit

Aktorët përgjegjës: DSHS, NJA, OJF, DRSHSSH

Objektivi 3.4 : Të ngrihen programe fuqizuese dhe shërbime për personat me AK.

Aktivitetet:

1. Vlerësimi i nevojave për shërbime për PAK;
2. Ngritja e nje sherbimi levizes per PAK ne banese
3. Venia ne funksionim e sherbimit.

Aktorët përgjegjës: DSHS, DRSHSSH, NJA, OJF

Objektivi 3.5 : Të krijohen shërbime komunitare multifunksionale për komunitetin Rom dhe Egjyptian.

Aktivitetet:

1. Ngritja e një qendre multifunksionale komunitare;
2. Ofrimi i programeve fuqizuese profesionale;
3. Ofrimi i programeve ndërmjetësuese për punësimin e Komunitetit Rom dhe Egjyptian;

Aktorët përgjegjës: DSHS, DRFP, NJA, ZRP, OJF

Objektivi 3.6: Të krijohen shërbime me bazë komunitare për personat me varësi nga substancat (alkoli, droga).

Aktivitetet:

1. Ngritja e një Qendre të kujdesit ditor për personat me varësi nga substancat;

Aktorët përgjegjës: DSHS, MMRS, NJA, OJF të specializuara

FUSHA 4 : ZBUTJA E VARFËRISË

Qëllimi 4: Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë në Bashkinë e Krujes

Objektivi 4.1: Të sigurohet mbështetja dhe fuqizimi i familjeve në nevojë

Aktivitetet:

1. Identifikimi i familjeve që nuk përfitojnë nga sistemi i NE
2. Miratimi i kriterëve që përfitojnë nga 6% dhe fondet e Bashkise
3. Ofrimi i mbështetjes për nevojat baze të familjeve

Aktorët përgjegjës: DSHS, NJA, OJF

FUSHA 5: PROGRAMET PARANDALUESE

Qëllimi 5: Planifikimi dhe ofrimi i programeve parandaluese

Objektivi 5.1: Të rritet niveli i ndërgjegjësimit i grupeve të rrezikuara

Aktivitetet:

1. Aktivitete edukuese për të rinjtë në shkollë
2. Program sensibilizues kundër diskriminimit;

Aktorët përgjegjës: DSHS, MMRS, NJA, DAR

Objektive 5.2: Të rritet ndërgjegjësimi publik për problemet sociale që shqetësojnë komunitetin

Aktivitetet:

1. Programe keshillimi për të rinjtë në shkollë
2. Programe ndërgjegjesimi kundër diskriminimit
3. Programe keshillimi për çiftet e reja.

Aktorët përgjegjës: DSHS, MMRS, DAR, NJA, OJF

Objektivi 5.3: Të ofrohen programe edukuese për fuqizimin e familjes në shërbimet egzistuese

Aktivitetet:

1. Programe edukuese për fuqizimin e familjes
2. Hartimi i programit
3. Venia në funksion e programit

Aktorët përgjegjës: DSHS, NJA, OJF

7. RAPORTIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I STRATEGJISË

Plani i Shërbimeve Sociale i Bashkisë Krujë (2017-2020) është një dokument politikash specifike për grupet dhe komunitetet e targetuara në territorin e Bashkisë, në përputhje të plotë me Strategjinë e Mbrojtjes Sociale (2015-2020) dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020).

Monitorimi i progresit të zbatimit të objektivave dhe masave të këtij plani do të paraqitet në mënyrë periodike dhe do të jetë pjesë e diskutimeve të strukturave drejtuese, Këshillit Bashkiak dhe partnerëve të tjerë vendorë.

Përgjegjëse për monitorimin e zbatimit e PSHS do të jetë Drejtoria e Shërbimeve Sociale me sektorët përkatës, të cilët mbledhin të dhënat dhe identifikojnë boshllëqet në informacionin që nevojitet. Ajo do të ketë gjithashtu rol koordinues dhe bashkërendues mbi ecurinë e zbatimit dhe do të ketë përgjegjësinë e përgatitjes së progres raporteve vjetore. Plani parashikon veprimtari të përmirësimit të sistemit të të dhënave, hartimit të instrumentave të standartizuara të raportimit si dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit me strukturat e nivelit rajonal, qendror dhe OJF-të.

Të dhënat administrative do të përdoren nga pjesa më e madhe e institucioneve vendore për të monitoruar pjesëmarrjen e grupeve në nevojë në programet e përgjithshme dhe të synuara të Bashkisë, siç janë shërbimet sociale, programet e ndihmës ekonomike, programet e strehimit, programet e punësimit, programet parandaluese, etj.

Një vëmendje e veçantë në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të PSHS-së do ti kushtohet ngritjes së kapaciteteve të punonjësve të institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për të garantuar mbledhjen e të dhënave të nevojshme duke mbrojtur njëkohësisht të drejtat e privatësisë të grupeve të targetuara.

Bashkia Krujë ka një rol koordinues në zbatimin dhe monitorimin e PSHS-së, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Sociale.

Gjithashtu Bashkia do të koordinojë procesin e mbledhjes së të dhënave nga të gjitha NJA, OJF-të dhe aktorët e tjerë vendor e rajonal të monitorimit dhe vlerësimit të arritjes së objektivave të saj. Bashkia do të lehtësojë gjithashtu koordinimin me organizatat ndërkombëtare, të cilat adresojnë çështjet e grupeve në nevojë përmes programeve të tyre.

Cikli i monitorimit dhe vlerësimit do të përfshijë:

- Vlerësimin formues të progresit dhe rishikimin e veprimeve të parashikuara në mes të afatit, në periudhën 2017-2020.
- Pas vlerësimit formues të progresit, Bashkia do të bëjë rishikimin dhe përditësimin e masave të PSHS-së për grupet e targetuara, duke patur parasysh edhe planifikimet buxhetore deri në vitin 2020.
- Një vlerësim përfundimtar që do të bëhet në fund të 2020, ku do të përcaktohet çdo çështje e pazgjidhur dhe zhvillime që mbeten për t'u realizuar.

Për garantimin e zhvillimit dhe zbatimit të objektivave PSHS të Bashkisë Krujë 2017-2020 (referuar në këtë strategji) do të:

- monitorohen treguesit e përcaktuar në plan;
- rekomandohen ndryshime në programet sektoriale, duke pasur parasysh arritjet, rrethanat (kihen parasysh këtu rreziqet) dhe eksperiencat e mëparshme;
- sigurohen konsultime me palët e interesit, përfshirë shpërndarjen sistematike të informacionit për publikun;
- Jepet kontribut në rritjen e konsistencës dhe integritetit të politikave dhe masave të Shërbimeve Sociale në të gjitha nivelet e administrimit, si dhe në përdorimin më të mirë të burimeve.

Baza kryesore e kuadrit monitorues të Planit të Shërbimeve Sociale 2017-2020, do të jetë lista e treguesve të monitorimit e paraqitur për secilin objektiv dhe aktivitet në Planin e Veprimit.

Mënyra e raportimit dhe konsultimit

Instrumenti kryesor në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të PSHS do të jetë Raporti Vjetor i Shërbimeve Sociale, i përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashkinë e Krujës. Raporti do të hartohet dhe miratohet brënda tre mujorit të parë të vitit pasardhës të vitit të monitoruar. Ky raport do të:

- Vlerësojë PSHS me fokus progresin e arritur në përmbushjen e masave dhe veprimtarive nga njëra anë dhe e treguesve të monitorimit nga ana tjetër;
- Identifikojë çështje të reja apo ato ndërvepruese, të cilat mund të trajtohen përmes një qasjeje më të koordinuar;

- Raportojë mbi pikëpamjet/këndvështrimet e aktorëve në nivel rajonal dhe lokal.

Roli i shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar në zbatimin e Planit të Veprimit

Plani i Veprimit identifikon organet shtetërore që janë përgjegjëse për zbatimin e secilit prej aktiviteteve, por një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve luajnë edhe grupet e tjera të interesit, të cilat lidhin institucionet me grupet në nevojë, si dhe financojnë ndërhyrjet e synuara për përmirësimin e situatës dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. OJF-të që punojnë për përmirësimin e jëtës së grupeve në nevojë dhe ofrojnë shërbime direkte për ta janë identifikuar veçanërisht si partnerë kyç për realizimin e objektivave të PSHS-së. Gjatë periudhës në vijim, Bashkia do të vazhdojë të mbështetet në ndihmën për ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve sociale, plotësimin e nevojave për strehim të sigurt, punësim dhe bashkëpunimin në fusha të tjera.

Komuniteti ndërkombëtar do të kontribojë gjithashtu në zbatimin e PSHS-së duke promovuar shembujt e praktikës së mirë nga Shqipëria dhe Rajoni, si dhe duke bashkëfinancuar disa prej aktiviteteve. Për të lehtësuar këtë proces, Bashkia ka identifikuar aktivitete specifike të PSHS-së që do të përmirësonin situatën e grupeve dhe komuniteteve në nevojë në territorin e Krujes.

BIBLIOGRAFI

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2015-2020

Ligj nr. 115/2014 datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Ligj nr. 107/2014 datë 31.7.2014 Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit

Ligj Nr. 10347/2010, “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”

Ligji për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, Nr.69/2012, i amenduar

Ligji Nr. 10221/2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

Ligji Nr. 10329/2010, “Për disa ndryshime dhe amendime në Ligjin Nr. 9669/2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”

Ligji Nr. 10399/2011, “Për disa mendime dhe shtojca” në Ligjin Nr. 9355/2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”

Ligji Nr. 163/2014, “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”

Ligji Nr. 9355/2005, “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” i ndryshuar

Strategjia ndërsektorial për decentralizimin dhe qeverisje vendore 2015-2020

Strategjia ndër sektoriale për reformën në administratën publike 2015 – 2020.

Strategjia për Drejtësinë e të Miturve, 2012-2020, Ministria e Drejtësisë

Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe plani i veprimit 2016-2020

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (2015 – 2020)

Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020

Strategjia e zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014-2020

Draft ligji për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë.

Unicef (2015) Supporting Planning of Social Care Services: SOCIAL CARE SERVICES PLANNING TOOLKIT⁵.